

# Trajnim për Liderë të Rinj

## Liderët kundër jotolerancës dhe ekstremizmit të dhunshëm

A jeni të moshës ndërmjet 18 dhe 30 vjeçe, të interesuar apo veçse të angazhuar në promovim të tolerancës, gjithëpërfshirjes apo përforcim të rezistencës së komunitetit tuaj ndaj radikalizimit të dhunshëm? A dëshironi të mësoni më shumë për atë që i shtyn njerëzit, sidomos të rinjtë, drejt ekstremizmit të dhunshëm? A jeni të interesuar të ndihmoni mbrojtjen e bashkëmoshatarëve tuaj dhe pjesëtarëve të komunitetit tuaj kundër kësaj? A jeni gatshëm të ofroni kohë dhe mund, çdo javë, në zhvillimin dhe realizimin e një nisme me bashkëmendimtarë të tjerë në muajt vijues? Atëherë, Trajnimi ‘**Liderët kundër jotolerancës dhe ekstremizmit të dhunshëm**’ (LIVE) është për ju.

## Çdokush mund të kontribuojë, sidomos të rinjtë!

Siguria është përgjegjësi e përbashkët. Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) punon me autoritetet publike dhe shoqërinë civile për të parandaluar dhe luftuar ngritjen e ekstremizmit të dhunshëm që mund të shpie në terrorizëm dhe krime të tjera. Aktivizimi i liderit të shoqërisë civile në nivel bazë është jetik për ruajtjen e njerëzve nga radikalizimi dhe rekrutimi në ekstremizëm të dhunshëm.

Të rinjtë kanë vështrim unik mbi dinamikën sociale lokale dhe qasje të posaçme tek moshatarët e tyre dhe pjesëtarët e tjerë të komunitetit. Ne besojmë tek udhëheqja, energjia dhe kapaciteti kreativ i tyre për të rritur vetëdijen, për të hapur rrugë alternative ndaj urrejtjes e jotolerancës, për të iniciuar e mundësuar dialog, për të promovuar mirëkuptim e respekt të ndërsjellë, për të ndikuar tek vendimmarrësit, si dhe për të sjellë ndryshime pozitive që adresojnë faktorët rrënjësorë të radikalizimit të dhunshëm në kontekste të ndryshme lokale.

## Duam t'ju ndihmojmë të veproni!

Trajnimi LIVE synon t'i frymëzojë e fuqizojë të rinjtë që ta shfrytëzojnë potencialin e tyre unik në ndërtim të rezistencës ndaj jotolerancës dhe ekstremizmit të dhunshëm – dhe të sjellin ndryshim. Si pjesëmarrës i trajnimit LIVE,

- ✓ **Do të fitoni njohuri e shkathtësi** për të ndërmarrë veprime në mënyrë të sigurt dhe efektive, përfshirë këtu të drejtat e njeriut, planifikimin dhe vlerësimin, angazhimin e palëve të interesit, si dhe njohuritë për siguri.
- ✓ **Do të merrni udhëzime kompetente** në identifikimin dhe zhvillimin e ideve të veprimit që janë kuptimplote për juve në mbrojtje të bashkëmoshatarëve tuaj dhe komunitetit.
- ✓ **Do të keni mundësi t'i ndani njohuritë dhe të mësoni nga të rinj të tjerë** nga e gjithë zona e OSBE-së.

## Mentorim drejt suksesit!

Trajnimi LIVE përbëhet nga dy module trajnimi me prani personale me nga një javë secili, si dhe një periudhë të ndërmjetme deri në tre muaj ndërmjet moduleve.

- ✓ Objektivi i **modulit të parë** është që të identifikoni një ide relevante veprimi që doni ta zhvilloni, si dhe hapat e planifikimit që duhen për ta shndërruar këtë ide në rezultat.
- ✓ Gjatë **periudhës së ndërmjetme**, do të punoni nga shtëpia dhe si të pavarur, për ta planifikuar idenë e veprimit më hollësisht, ku ofrohet edhe mbështetja në kuptimin e këshillave dhe financimit të kufizuar fillestar.
- ✓ Në **modulin e dytë**, do të ritakoheni me pjesëmarrësit tjerë për të ndarë me ta sukseset dhe vështirësitë, ashtu që të finalizoni projektin tuaj të veprimit.

Java e parë e pilot-trajnimit do të mbahet nga **16 deri më 20 prill** në Prishtinë. Java e dytë do të mbahet nga **25 deri më 30 qershor** (vendi do të përcaktohet). Pjesëmarrja është pa pagesë. Shpenzimet e udhëtimit dhe qëndrimit për pjesëmarrësit që jetojnë jashtë Prishtinës do të mbulohen nga OSBE-ja. Megjithatë, ndjekja e trajnimit kërkon një investim të konsiderueshëm të kohës suaj personale gjatë periudhës së trajnimit, si dhe më pastaj, për ta zhvilluar e zbatuar iniciativën tuaj më tutje. Të gjitha seancat do të mbahen në anglisht, me përkthim simultan në shqip dhe serbisht.

### **Kush mund të aplikojë dhe si?**

Për të aplikuar, duhet të jeni të moshës 18 deri 30 vjeçe, si dhe të jeni me qëndrim në Kosovë. Duhet të keni përkushtim të fuqishëm ndaj të drejtave universale të njeriut dhe të jeni të vendosur të veproni kundër jotolerancës dhe ekstremizmit të dhunshëm. Ju lutemi të dërgoni CV-në tuaj (që përfshin përvojat tuaja të mundshme vullnetare) si dhe një deklaratë të shkurtër të motivimit tuaj (preferohet në anglisht, por është e pranueshme edhe në shqip dhe serbisht), tek adresa vijuese e postës elektronike [Dafina.Bajrami-Elshani@osce.org](mailto:Dafina.Bajrami-Elshani@osce.org). **Afati i fundit për dorëzim të aplikacionit është 25 shkurt 2018.**